

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tabaku: Korrupsioni është taksa e fshehtë që paguan çdo shqiptar
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/tabaku-korrupsioni-eshte-taksa-e-fshehte-qe-paguan-cdo-shqiptar-i588474
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 07:31:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 07:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	46ca82a02600be9966b246437e364a5bc2c48937659fc229eb47a7d97ee0b93c
TEKSTI	3c2c0890c5ee5356a1170552281323b6536bcc7bdb91de9ed8b5ac055350d2d7
PAMJA	9f03cce2479bc9fd5a855191fd5a797045ee52209ea4db4190813b8468b25cc3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7932f4de65fa3a091264da72fb947e93193e00c990f4034c2c785184b1c232ba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c5ef72e280ad02d10fcef52ca02446c3f1a387185640f8c3107dbc4e00e7b78
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7932f4de65fa3a091264da72fb947e93193e00c990f4034c2c785184b1c232ba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



le ["Tabaku: Korrupsioni është taksa e fshehtë që paguan çdo shqiptar"](#) Facebook rrezikon gjobe deri ne 10.5 miliarde dollare pas vendimit te jurise ne New MexicoSot ndeshja fundit

Tabaku: Korrupsioni është taksa e fshehtë që paguan çdo shqiptar



26 Shtator 2026, 09:30Politika TEMA



Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, e ka vendosur korrupsionin në qendër të “Këndit të Fundjavës”, duke e lidhur atë drejtpërdrejt me rritjen e kostos së jetesës, dobësimin e ekonomisë dhe humbjen e vendeve të punës.

Sipas Tabakut, korrupsioni nuk është një dukuri e largët nga përditshmëria e qytetarëve, por një faturë që paguhet çdo muaj nga familjet dhe sipërmarrjet shqiptare.

“Kur një tender fryhet, diferencën e paguan qytetari. Kur një kontratë i jepet mikut dhe jo kompanisë më të mirë, humbet sipërmarrësi i ndershëm. Kur paratë publike shkojnë te klientët e pushtetit, ato mungojnë për pensionet, shkollat, shëndetësinë dhe mbështetjen e prodhimit”, deklaroi Tabaku.

Ajo e cilësoi korrupsionin si “taksën e fshehtë” që merr çdo ditë një pjesë nga të ardhurat e shqiptarëve.

Deputetja demokrate solli si tregues edhe rritjen e çmimeve. Duke iu referuar të dhënave të INSTAT-it, ajo tha se në dhjetor 2025 niveli i përgjithshëm i çmimeve ishte 20,9 për qind më i lartë se në dhjetor 2020, ndërsa çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike ishin rritur me 35,6 për qind.

“Edhe kur inflacioni vjetor ngadalësohet, çmimet nuk kthehen pas. Ato mbeten në nivelin e ri, ndërsa familja vazhdon ta paguajë çdo ditë diferencën”, u shpreh Tabaku.

Sipas saj, vështirësitë e familjeve shoqërohen me dobësimin e prodhimit dhe të eksporteve. Tabaku deklaroi se eksportet e mallrave ranë nga rreth 430 miliardë lekë në vitin 2023 në 346 miliardë lekë në vitin 2025, ndërsa deficitin tregtar arriti në 541 miliardë lekë.

Në fokus të analizës së saj ishte industria e tekstileve dhe këpucëve, eksportet e së cilës, sipas shifrave të paraqitura prej saj, ranë me rreth 22,4 miliardë lekë brenda dy vjetësh. Tabaku paralajmëroi se pas këtyre treguesve qëndrojnë mijëra vende pune, kryesisht të grave dhe të familjeve në zona ku mundësitë e tjera të punësimit janë të kufizuara.

Ajo vlerësoi se zhvlerësimi i euros ka qenë një goditje shtesë për eksportuesit shqiptarë, të cilët arkëtojnë në euro, por paguajnë në lekë pagat, energjinë, sigurimet dhe një pjesë të kostove të prodhimit.

Tabaku ngriti gjithashtu pikepyetje per krijimin dhe funksionimin e shoqerise "Guna Tactical", te ngritur per prodhimin e uniformave ushtarake. Ajo kerkoi transparencë për përzgjedhjen e partnerit privat, vlerën e pasurisë publike të vendosur në dispozicion, kontratat e garantuara dhe kalimin e shtetit nga aksioner shumice në aksioner pakice.

"Nuk jemi kundër prodhimit vendas të uniformave. Përkundrazi, duam që çdo produkt që mund të prodhohet në Shqipëri të mbajë vulën 'Made in Albania'. Por 'Made in Albania' nuk duhet të shndërrohet në 'Made for the friends of government'", theksoi ajo.

Deputetja e PD-së kërkoj publikimin e marrëveshjeve dhe kontratave të shoqërive të KAYO-s, transparencë mbi pronarët përfitues, auditim të pavarur të pasurive publike dhe konkurrin të hapur për furnizimet.

Për industrinë përpunuese, Tabaku propozoi rimbursim më të shpejtë të TVSH-së, mbështetje të lidhur me ruajtjen e vendeve të punës, financim për teknologjinë dhe eficiencën energjetike, trajnim profesional dhe kalimin nga fasoneria drejt prodhimit me cikël të plotë dhe markave shqiptare.

"Shqipëria nuk mund të ketë si produktin e saj më të suksesshëm korrupsionin. Duhet të prodhojë ushqime, veshje, këpucë, teknologji, ide dhe vende pune të paguara mirë", deklaroi Tabaku.

Në përfundim, ajo e drejtoi përgjegjësinë politike te qeveria socialiste dhe kryeministri Edi Rama, duke argumentuar se modeli aktual favorizon një pakicë të lidhur me pushtetin në kurriz të familjeve, punonjësve dhe sipërmarrësve të ndershëm.

"Shqiptarët po punojnë. Sipërmarrësit po përpiqen. Ajo që nuk po punon për ta është qeveria", përfundoi Tabaku.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t'i dorëzojë letrat kredenciale Begajt](#)

08:30 Politika / 1 koment

[Fjala e PLOTË/ Edi Rama në OKB: Makineria e Inteligjencës Artificiale do të bindet, pyetja është 'kujt'](#)

21:20 Politika / 22 komente

[Balla nga selia e OKB: Nën drejtimin e Kryeministrit Rama, Shqipëria është ngjitur në majën më të lartë të historisë së saj shtetërore](#)

20:50 Politika / 21 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.